

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me procesmbajtësen Shyhrete Sopaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit D S nga sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP.nr.1628/15 të datës 12.05.2016, për shkak të kryerjes së veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KP-së, në shqyrtimin fillestar në prezencën e Prokurorit të Shtetit Fatos Ajvazi, dhe të akuzuarit D S me datë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M**I akuzuari:**

D S, nga i ati dhe e ëma i lindur L i lindur më në , ku edhe tani banon në rr. " " nr. ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se më datën 17.12.2013 rreth orës 18: 55 minuta, në në rrugën " ", i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit , që rezulton me pasoja të përkohshme në shëndet, në atë mënyrë që për shkak të një mosëmarrëveshje të mëhershme, në momentin që vëren të dëmtuarin, fillon ta godas me grushta në fytyrë, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje (mbrejthe) të indeve të buta të regjionit të faqes së majtë të fytyrës.

Kështu që ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 para.1 nën. par. 1.4 të KP-së.


Andaj gjykata në bazë të dispozitave të neneve 4, 6, 7,17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, të KP-së, të akuzuarit i'a shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

I'a vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

I dëmtuari S (Z) Z nga rr. " " nr. , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civilo-juridik.

I akuzuari, obligohen që t'i paguajë shpenzimet e gjykatës, aq sa do të jenë ato sipas llogarisë së arkës së kësaj gjykate, për ekspertizën mjeko ligjore 20 euro dhe për paushallin gjyqësor shumën prej 50 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.



Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur aktakuzë PP.nr. 1628/15 të datës 12.05.2016, kundër të akuzuarit D S nga , për shkak të kryerjes së veprës penale të lëndimit të lehët trupor nga neni 188 par.1 nën. par. 1.4 të KP-së.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar më datën 08.05.2017 në prezencën e prokurorit dhe të akuzuarit. Pas kësaj u lexua aktakuza nga ana e Prokurorit të Shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provat materiale në të cilat mbështetet aktakuza. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe se e ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer dhe pranueshmërinë e provave, duke shtuar se i vie keq për veprën që ka ndodhur dhe në të ardhmen nuk do të kryje vepra të tilla.

Gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:


Se më datën 17.12.2013 rreth orës 18: 55 minuta, në rrugën “ ”, i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit S Z , që rezulton me pasoja të përkohshme në shëndet, në atë mënyrë që për shkak të një mosëmarrëveshje të mëhershme, në momentin që vëren të dëmtuarin, fillon ta godas me grushta në fytyrë, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore dhe atë: ndrydhje (mbrejthe) të indeve të buta të regjionit të faqes së majtë të fytyrës

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, për veprën penale, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat, gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezentuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër, dhe se aktakuza nuk përmbante asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptimin e këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit t'i shpall fajtor dhe t'i gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij. Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësin e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KP-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, se në gjykim ka patur qëndrim korrekt, pranimi i fajësisë, nuk ka qenë të dënuar më parë, është penduar për veprën e kryer. Ndërkaq gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese andaj ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe se ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë konform nenit 463 par. 2 të KP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 451 par.1 dhe 453 par. 1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.989/16, me datë 08.05.2017

Procesmbajtësja
Shyhrete Sopaj



Gjyqtari
Mehmet Ndrecaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.